

VENDIM
(i shkurtuar)

Nr. 6659, datë 5.7.2019

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTARE: TEUTA HOXHA

asistuar nga sekretare gjyqësor Adela Çinari, në datën 5.7.2019 mori në shqyrtim me dyer të hapura çështjen civile me nr. 6659 Akti, që iu përket:

KËRKUES: Pëllumb Veizaj, i biri i Qaniut dhe Dylberes, i datëlindjes 7.12.1953, lindur dhe banues në Tiranë, Rr.: “Sali Butka”, ndërtesa 11, hyrja 1, ap. 44, përfaqësuar në gjykim me prokurë të posaçme nr.31 rep., dhe 14 kol., datë 7.1.2019 nga Av.Denis Hyka.

PERSONA TË TRETË: Shoqëria “Albit Diabra” sh.p.k., person juridik i së drejtës shqiptare, me NUIS J61901003E, me seli në Tiranë, rruga: “Jordan Misja”, Tiranë me administrator G. Janaqi, përfaqësuar në gjykim me prokurë të posaçme nr. 1724 rep., dhe 632 kol., datë 10.4.2019 nga av. Dorian Çeliku dhe av. Fation Vila.

OBJEKTI: Fillimi i procedurave të falimentimit të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 153; 334 e vijues të K.Pr.Civile; nenet 13, 17, 18, e vijues të ligjit nr.110/2016 “Për falimentimin”.

Gjykata, si dëgjoi raportin e paraqitur prej administratores së përkohëshme dhe si shqyrtoi në tërësi kërkesat dhe pretendimet e palëve dhe aktet e paraqitura;

Konform nenit 127 të K. Pr. Civile dhe nenit 26 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, gjykata

VENDOSI:

- 1) Pranimin e kërkesës.
- 2) Hapjen në orën 13:00 të datës 5 korrik 2019 të procedurës së falimentimit për shoqërinë tregtare “Albit Diabra” sh.p.k., me NUIS J61901003E, me seli në Tiranë, Rr. “Jordan Misja”, Tiranë.
- 3) Emërimin administratore të falimentimit zj. Shpresa Breçani, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë me licencë nr. 9 dhe NIPT K71529023K, me adresë veprimtarie: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara El”, sh. 1, ap. nr. 1, Tiranë.
- 4) Të gjitha subjektet që kanë detyrime ndaj debitorit “Albit Diabra sh.p.k.” duhet t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë administratores së falimentimit për llogari të shoqërisë në falimentim.
- 5) Të gjitha subjektet, që posedojnë apo zotërojnë pasuri të debitorit “Albit Diabra”sh.p.k., duhet të njoftojnë administratoren e falimentimit, së bashku me titullin e zotërimit apo të drejtës.
- 6) Administratorja e falimentimit t’i paraqesë gjykatës së falimentimit raport mbi listën transaksioneve të kryera nga “Albit Diabra” sh.p.k. në 3 (tre) muajt e fundit, të kryejë vlerësimin e duhur ligjor të tyre për mundësinë mbi anulimin veprimeve juridike sipas kriterëve përkatëse të përcaktuara në ligjin “Për falimentimin”.
- 7) Të gjithë kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë që, brenda 45 ditëve nga data e publikimit të këtij vendimi, të gjitha pretendimet e tyre t’i paraqesin tek administratorja e falimentimit, duke i njoftuar asaj pretendimet dhe të drejtat e siguruara që kanë mbi pasuritë e debitorit.
- 8) Mbledhja e kreditorëve për raportim dhe caktimin e komitetit të kreditorëve caktohet në datën 25 shtator 2019, ora 11:00.

9) Mbledhja e kreditorëve të subjektit “Albit Diabra” sh.p.k., për verifikimin e pretendimeve do të përcaktohet gjatë mbledhjes së raportimit. Data përkatëse e mbledhjes për verifikim vendoset në mbledhjen për raportim.

10) Urdhërohet ndalimi i ekzekutimit jashtë procedurës së falimentimit mbi të gjithë pasuritë e veçanta apo të drejtat pasurore të debitorit nga çdo kreditor apo palë e tretë.

11) Urdhërohet administratorja e falimentimit që një kopje të vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë, të gjithë kreditorëve të listuar dhe debitorëve të njohur të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k.

12) Urdhërohet sekretaria gjyqësore që një kopje të vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k. t’ia njoftojë administratores së falimentimit, debitorit “Albit Diabra” sh.p.k., Autoritetit Rrugor Kombëtar, Autoritetit Portual Shqiptar, Zyrës së Regjistrimit të Barrëve Siguruese, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

13) Urdhërohet publikimi i vendimit të shkurtuar për hapjen e procedurës së falimentimit të Shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k. në Fletoren Zyrtare, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14) Shpenzimet gjyqësore proceduriale në ngarkim të debitorit.

15) Ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm.

16) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve afat që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

17) U shpall në Tiranë, më 5 korrik 2019.

SEKRETARE

ADELA ÇINARI

GJYQTARE

TEUTA HOXHA